



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA	REPUBLIKA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU	
Adresa/Adr:	150
Data/Datum:	30 07 2019
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE	



Datë: 29.07.2019

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 25.07.2019, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 248, të datës 19.06.2019, paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban, i shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 10, paragrafi 10.5, shkronja (b), nenin 13, paragrafi 13.1, shkronja (a), të Ligjit për tokën bujqësore Nr. 02/L-26 (Gazeta Zyrtare Nr. 13/2007), nenin 8, paragrafi 1, nën paragrafi 1.3, të Ligjit për rregullimin e tokës Nr. 04/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 03/2012), nenin 6, paragrafi 6.3, nenin 9 të Udhëzimit Administrativ Nr. 41/2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 61, paragrafi 5, të Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale Nr. 125, të datës 25.09.2014, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit Nr. 248, të datës 19.06.2019, për shndërrimin e përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore për palën Nazif Muharrem Nazifi në Fushë-Kosovë

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 248, të datës 19.06.2019, për shndërrimin e përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, të ngastrës kadastrale Nr. P-72514036-02665-2, me sipërfaqe $S=2870m^2$, arë e klasës së pestë, pronë private me posedim individual në vendin e quajtur 'Latkovica-Vel.Latko' për palën Nazif Muharrem Nazifi në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë.
2. Shndërrimi i tokës bujqësore në tokë ndërtimore bëhet për zhvillimin e biznesit të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar 'Koral Home' me numër të biznesit Nr. 811298125.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për shndërrimin e përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU, Drejtorisë së BZHR, Palës dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 29.07.2019

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 25.07.2019, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 269, të datës 16.07.2019, paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban, i shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 14, nenin 17, nenin 19, paragrafi 2, të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110, (Gazeta Zyrtare Nr. 18/2012), nenin 10, nenin 11, të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174, (Gazeta Zyrtare Nr. 30/2013), nenin 4, paragrafi 1, paragrafi 2, nenin 7, pika 4 e shtojcës për norma teknike të planifikimit hapësinor, të Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2017, nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 35, paragrafi 3, paragrafi 4, të Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale Nr. 125, të datës 25.09.2014, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit Nr. 269, të datës 16.07.2019, për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 55, të datës 09.06.2011

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 269, të datës 16.07.2019, për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 55, të datës 09.06.2011, Planit Zhvillimor Urban - Revidimi 2015/2021, implementimin e vendimit Nr. 81, të datës 15.05.2017, interpretimit ligjor Nr. 56, të datës 22.11.2018, Urdhëresën Nr. 1152, të datës 22.07.2019 dhe lejimin e ndërtimit duke u bazuar në rregullat e paraparë të ndërtimit me Udhëzimin Administrativ Nr. 08/2017, për caktimin e distancave ndërmjet ndërtesave duke zbatuar normativat dhe rregullat e ndërtimit si vijon:
 - 1.1 Distanca ndërmjet ndërtesave: Nënkupton gjatësinë e një vije pingul ndërmjet dy anëve të ndërtesave përballë njëra-tjetrës;
 - 1.2 Distanca minimale ndërmjet ndërtesave të banimit, me kthina primare në fasada është jo më e vogël se lartësia e ndërtesës më të lartë të banimit. Në rast të pamundësisë, në zona veç se të ndërtuara (të mbushura me ndërtim - sipërfaqe të shputave, më shumë se 60%), aplikohet rregulli 4.2.9;
 - 1.3 Distanca minimale ndërmjet ndërtesave të banimit në anët në të cilat nuk ka hapje primare apo ka vetëm hapje të kthinave sekondare është jo më e vogël se ≥ 4.00 m ose $= 0.00$ m me kusht që të respektohen rregullat për mbrojtjen nga zjarri. Në rast se distancës të barabartë me 0.00 m, vendosja e nënkalimit për automjetet për zjarr-fikje është me gjerësi ≥ 4.00 m dhe Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor 43 lartësi ≥ 5.00 m;

- 1.4 Distanca minimale ndërmjet ndërtesave të banimit, me kthina primare në fasada; nga ndërtesat afariste të cilat nuk ndikojnë në privatësinë e banimit, është jo më e vogël se lartësia e ndërtesës afariste;
- 1.5 Distancat në mes objekteve industriale përcaktohen në përputhje me rregullat e sigurisë së ndërtesës dhe aktiviteteve që zhvillohen në to, siç është përcaktuar në legjislacionin në fuqi. Distanca në mes të një objekti industrial dhe një ndërtese jo industriale nuk duhet të jetë më pak se lartësia maksimale mbi tokë e ndërtesës më të lartë fqinje;
- 1.6 Pavarësisht nga dispozitat e këtushme, distancat duhet të jenë mjaft të mëdha për të siguruar qasje të drejtpërdrejtë të automjeteve të mbrojtjes nga zjarri dhe mjeteve të tjera të emergjencave në të paktën dy anë të ndërtesës, dhe në mes të ndërtesave. Në rast të pamundësisë, përcaktohet nënkalim për automjetet e mbrojtjes nga zjarri që duhet të jetë të paktën 4 metra i gjerë dhe 5 metra i lartë;
- 1.7 Siguria nga zjarri, ndërmjet dy ndërtesave fqinje kërkon që distanca minimale ndërmjet ndërtesave është së paku gjysma e lartësisë të ndërtesës më të lartë. Kjo distancë minimale zbatohet për të gjitha llojet e ndërtesave në të gjitha zonat specifike, nën zonat, zonat mbishtresore dhe sipërfaqet rregulluese;
- 1.8 Distanca minimale ndërmjet ndërtesës dhe kufirit anësor dhe të pasmë të parcelave kadastrale, me kthina primare në fasada është jo më e vogël se gjysma e lartësisë së ndërtesës më të lartë të banimit. Në rast të pamundësisë, në zona veç më të ndërtuara (të mbushura me ndërtim më shumë se 60%), është së paku një e katërta (1/4) e lartësisë të ndërtesës më të lartë;
- 1.9 Nëse nuk përcaktohet ndryshe me dokumentet e planifikimit hapësinor, ndërtimi mund të bëhet në kufijtë e parcelës kadastrale për zhvillim të vendosura përgjatë rrugës, kur vija ndërtimore (VN) përputhet me vijën rregulluese (VRR). Për ndërtim në kufijtë e parcelës, i vendosur përgjatë fqinjëve nevojitet marrëveshja paraprake me fqinjët. Në këtë rast, fasadat kah kufijtë me fqinjët nuk mund të kenë hapje dhe duhet izoluar për mbrojtje nga zjarri;
- 1.10 Në ndërtimet e banimit individual përqindja e ndërtimit të jetë 33% e parcelës kadastrale;
- 1.11 Objektet e banimit kolektiv ndërtohen aty ku sipërfaqja e parceles kadastrale ka min 10 ari. Nëse parcela nuk i ka 10 ari atëherë duhet bërë bashkimi i parcelave kadastrale fqinje. Pjesa e përparme e këtyre parcelave që ka qasje me rrugën publike të ketë gjerësinë minimale 25m’;
- 1.12 Në rast të pamundësisë, në zona veç më të ndërtuara (të mbushura me ndërtim në të gjitha anët aty ku nuk mund të bëhet bashkimi i parcelave fqinje për formimin e parceles me sipërfaqes minimum 10 ari sepse ndërtimi anash veq ka perfunduar) duhet të përcillet vija ndërtimore e bllokut si dhe të përcillen standardet e Mbrojtjes nga zjarri;
- 1.13 Në ndërtimet e banimit kolektiv përqindja e sipërfaqes së shfrytëzuar për ndërtim do të jetë max (40% e sipërfaqes ndërtuese me bazë të Përdhësës) ku koeficienti i ndërtimit arrin në 3.2 dhe me Etazhitet maximal B+P+7E dhe lartesi maksimale të ketë objekti 28m’;
- 1.14 Në Banimet Kolektive konzollat lejohen në distancë 120cm, si terasa deri në 140 cm, të cilat hynë në kuadër të koeficientit të ndërtimit ose sipërfaqes shfrytëzuese të ndërtimit (40% e sipërfaqes ndërtuese);
- 1.15 Bodrumi mund të ndërtohet dhe të vëhet në shfrytëzim deri në 70% të sipërfaqes së

parcelës ku niveli i dyshemesë së përdheses me tokë të jetë me nivelin 0-0, kurse lartësia e bodrumit dysheme - tra të jetë 220cm. Kjo përqindje vlen nëse kërkohet nga pala apo investitori.

2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Planifikimit Urban, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për fushën e ndërtimit, konform rregullave dhe normativave të ndërtimit të cekura në pikën një të vendimit dhe vlenë së zbatuari deri në miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës dhe shfuqizon vendimin Nr. 55, të datës 09.06.2011.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU, dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU
Nr./No/Dok. 152
Data/Datum 30 07 2019
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE

Datë: 29.07.2019

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 25.07.2019, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 754, të datës 16.07.2019, paraqitur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në lidhje me kërkesën Nr. 02-070/05-0021231/19, të datës 17.06.2019 të paraqitur nga pala Avni Ademi, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (ç), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 41, paragrafi 16, nenin 43, paragrafi 7, të Rregullores për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale Nr. 125, të datës 25.09.2014, nenin 13, paragrafi 3, të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr. 83, të datës 14.06.2013, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e propozimit për lejimin e mjeteve financiare për shërim

1. Për aprovimin e propozimit për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 5,000.00€, për shërim shëndetësorë, për palën Avni Ademi nga fshati Henc i Komunës së Fushë-Kosovës, i cila vuan nga sëmundja me diagnozë Dg: Class I-II St. post implantum DDDIR ICD, pacienti aktualisht është me dyspnea dhe PND, si dhe NYHA - Class II.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për sigurimin e mjeteve financiare, për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB, Drejtorisë së SHMS, Palës dhe Arkivës.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 29.07.2019

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 25.07.2018, pas shqyrtimit të shkresës Nr. 0204-940/8, të datës 11.07.2019 për rishqyrtimin e aktit Nr. 123, të datës 10.06.2019, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (c), nenin 17, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a, l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, nenin 14 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 22, paragrafi 1, nenin 23, të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110 (Gazeta Zyrtare Nr. 18/2012), nenin 4, nenin 5, nenin 10, nenin 11 dhe nenin 12 të Udhëzimit Administrativ për taksat administrative për leje ndërtimore, leje rrërimi dhe tarifave për rregullimin e Infrastrukturës Nr. 02/2018, nenin 12, paragrafi 12.1 shkronja (ç, nj), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b, nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, miratoi:

Rishqyrtimin e aktit Nr. 123 të datës 10.06.2019 sipas shkresës Nr. 0204-940/8 të datës 11.07.2019, për ndryshim-plotësimin e Rregullores për tarifa ngarkesa dhe gjoba komunale për taksat e ndërtimit për vitin 2019

1. Miratohet ndryshim-plotësimi i Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale Nr. 63, të datës 16.05.2013, për caktimin e taksës administrative për lëshimin e lejes ndërtimore, tarifës rregullative për rritjen e densitetit në infrastrukturë, taksës për leje të rrënimit për vitin fiskal 2019.
2. Me këtë ndryshim-plotësim të Rregullores shfuqizohet, ndryshim-plotësimi i Rregullores për tarifa ngarkesa dhe gjoba komunale Nr. 121 i datës 13.06.2018 dhe caktohet taksa administrative për lëshimin e lejes ndërtimore, taksa administrative për lejimin e rrënimeve dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në infrastrukturë për vitin fiskal 2019, për territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, Nr. 1039-2/19, të datës: 11.03.2019, për ndërtimet e kategorisë së parë dhe kategorisë së dytë të objekteve për njësitë e reja të banimit si vijon:
 - 2.1 Taksa administrative për lëshimin e lejes ndërtimore për vitin fiskal 2019 për kategorinë e parë të ndërtimeve është në vlerë prej 1,51€ për një metër katror e sipërfaqes bruto të pllakës ndërtimore, duke mos llogaritur perimetrin e fasadës;
 - 2.2 Taksa administrative për lëshimin e lejes ndërtimore për vitin fiskal 2019 për kategorinë e dytë të ndërtimeve është në vlerë prej 1,96€ për një metër katror e sipërfaqes bruto të pllakës ndërtimore, duke mos llogaritur perimetrin e fasadës;

- 2.3 Taksa administrative për lëshimin e lejes për rrënimin e objekteve ndërtimore për vitin fiskal 2019 është në vlerë prej 0,89€ për një metër katror bruto;
- 2.4 Tarifa rregullative për rritjen e densitetit në infrastrukturë për vitin fiskal 2019, zbatohet për njësitë e reja të banimit dhe është e ndikuar nga rritja e popullsisë në komunën tonë dhe shërbimet komunale që ofrohen në: arsim, përkujdesje shëndetësore, shërbime publike, mbrojtje e shpëtim, kulturë, rini e sport për kokë banori në komunën tonë, është fituar vlera prej 237.61€, e cila tarifë në zbërthim i bie të jetë 4.75€ për një metër katror të sipërfaqes neto;
- 2.5 Objektet publike institucionale që financohen nga Institucionet shtetërore lirohen nga taksa për leje ndërtimore.
3. Këto tarifa aplikohen për punët ndërtimore, që rrisin numrin e njërive të reja banuese, shtëpi për vetëm një familje dhe ndërtesa për shumë familje-bloqet e apartamenteve.
4. Llogaritja dhe caktimi i taksës administrative për leje ndërtimore, lejes për rrënim dhe tarifës rregullative për rritjen e densitetit në infrastrukturë, nga pika dy (2) e këtij ndryshim-plotësimi të Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba, do të bëhet nga Drejtoria për Planifikim Urban.
5. Për zbatimin e këtij ndryshim-plotësim të Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, është kompetente Drejtoria për Planifikim Urban.
6. Ky ndryshim-plotësim i Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba Nr. 63, të datës 16.05.2013, hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës dhe shfuqizon, ndryshim-plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba Nr. 121 të datës 13.06.2018 dhe vlenë së zbatuari deri në miratimin e taksave dhe tarifës së re për ndërtime.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së PU dhe Arkivës.**


**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 06.06.2019

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 30.05.2018, pas shqyrtimit të dytë të Propozimit Nr. 102, të datës 13.03.2019, paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (c), nenin 17, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a, l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, nenin 14 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 22, paragrafi 1, nenin 23, të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110 (Gazeta Zyrtare Nr. 18/2012), nenin 8, nenin 10, të Udhëzimit Administrativ për lëshimin e lejes ndërtimore dhe tarifave për rregullimin e Infrastrukturës Nr. 22/2012, nenin 12, paragrafi 12.1 shkronja (ç, nj), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b, nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, miratoi këtë:

NDRYSHIM-PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR TARIFA NGARKESA DHE
GJOBA KOMUNALE PËR TAKSAT E NDËRTIMIT PËR VITIN 2019

1. Miratohet ndryshim-plotësimi i Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale Nr. 63, të datës 16.05.2013, për caktimin e taksës administrative për lëshimin e lejes ndërtimore, tarifës rregullative për rritjen e densitetit në infrastrukturë, taksës për leje të rrënimit për vitin fiskal 2019.
2. Me këtë ndryshim-plotësim të Rregullores shfuqizohet, ndryshim-plotësimi i Rregullores për tarifa ngarkesa dhe gjoba komunale Nr. 121 i datës 13.06.2018 dhe caktohet taksa administrative për lëshimin e lejes ndërtimore, taksa administrative për lejimin e rrënimeve dhe tarifa rregullative për rritjen e densitetit në infrastrukturë për vitin fiskal 2019, për territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, Nr. 1039-2/19, të datës: 11.03.2019, për ndërtimet e kategorisë së parë dhe kategorisë së dytë të objekteve për njësitë e reja të banimit si vijon:
 - 2.1 Taksa administrative për lëshimin e lejes ndërtimore për vitin fiskal 2019 për kategorinë e parë të ndërtimeve është në vlerë prej 1,51€ për një metër katror e sipërfaqes bruto të pllakës ndërtimore, duke mos llogaritur perimetrin e fasadës;
 - 2.2 Taksa administrative për lëshimin e lejes ndërtimore për vitin fiskal 2019 për kategorinë e dytë të ndërtimeve është në vlerë prej 1,96€ për një metër katror e sipërfaqes bruto të pllakës ndërtimore, duke mos llogaritur perimetrin e fasadës;

- 2.3 Taksa administrative për lëshimin e lejes për rrënimin e objekteve ndërtimore për vitin fiskal 2019 është në vlerë prej 0,89€ për një metër katror bruto;
- 2.4 Tarifa rregullative për rritjen e densitetit në infrastrukturë për vitin fiskal 2019, zbatohet për njësitë e reja të banimit dhe është e ndikuar nga rritja e popullsisë në komunën tonë dhe shërbimet komunale që ofrohen në: arsim, përkuqdesje shëndetësore, shërbime publike, mbrojtje e shpëtim, kulturë, rini e sport për kokë banori në komunën tonë, është fituar vlera prej 237.61€, e cila tarifë në zbërthim i bie të jetë 4.75€ për një metër katror të sipërfaqes neto;
- 2.5 Objektet publike institucionale që financohen nga Institucionet shtetërore lirohen nga taksa për leje ndërtimore.
3. Këto tarifa aplikohen për punët ndërtimore, që rrisin numrin e njësive të reja banuese, shtëpi për vetëm një familje dhe ndërtesa për shumë familje-bloqet e apartamenteve.
4. Llogaritja dhe caktimi i taksës administrative për leje ndërtimore, lejes për rrënim dhe tarifës rregullative për rritjen e densitetit në infrastrukturë, nga pika dy (2) e këtij ndryshim-plotësimi të Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba, do të bëhet nga Drejtoria për Planifikim Urban.
5. Për zbatimin e këtij ndryshim-plotësim të Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale, është kompetente Drejtoria për Planifikim Urban.
6. Ky ndryshim-plotësim i Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba Nr. 63, të datës 16.05.2013, hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës dhe shfuqizon, ndryshim-plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba Nr. 121 të datës 13.06.2018 dhe vlenë së zbatuari deri në miratimin e taksave dhe tarifës së re për ndërtime.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së PU dhe Arkivës.**

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha**

